

VENDIM

Nr. 475, datë 8.6.2017

PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË NATO-S NË LETONI

(Ndryshuar me VKM nr.126, datë 7.3.2018 dhe nr. 740, datë 20.11.2019)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një toge EOD, të përbërë nga 21 *(njëzet e një)* ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni.

2. Misioni i personelit të togës EOD është kryerja e detyrave në mbështetje të grup-batalionit të Kanadasë.

3. Togës EOD, që merr pjesë në këtë mision, nuk i lejohej të angazhohet për asgjësim municionesh CBRN, ndërtim fushash të minuara (FM) dhe detyra trajnimi për të tjerët.

4. Venddislokimi i togës EOD të jetë në Riga, Letoni.

5. *Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2021, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit, për çdo togë, të jetë 6 (gjashtë) muaj, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.*

6. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) ushqim;

dh) akomodim;

e) ujë;

ë) lavanderi;

f) shërbim telefonik, interneti, konfigurim PC në rrjetin “NATO Sekret” dhe shërbime postare;

g) materiale konsumi për aparatura;

gj) mirëmbajtje pajisjesh dhe aparaturash;

h) transport;

i) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

j) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

k) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Transporti i personelit që do të marrë pjesë në misionin në Letoni ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç

rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala /palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

8. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama